

Living

Personazh



Alba Halilaj
E apasionuar pas
lirise së profesionit

E apasionuar pas lirisë së profesionit

Një vajzë e lindur në Lushnjë, me një natyrë shumë ëndërrimtare, që çuditi një pjesë të mirë të njerëzve, kur zgjodhi teknologjinë e informacionit si degë studimi, ndërkohë që një pjesë e tyre prisnin diçka më artistike për natyrën e saj. Për vite të tëra u end në rolet klasike të një të riu në tregun tonë duke u bërë pjesë e kompanive më të mëdha asokohe siç ishin ato të telekomunikacionit. Vite më vonë fati e vuri përballë një zgjedhje, ku mund të punonte në drejtimin e projekteve duke qenë një eksperte e lirë, freelance, e pa lidhur me asnjë kompani. Me kalimin e kohës ajo që nisi si një punë e pjesshme, me një ekip me tre persona filloi të merrte përmasa të mëdha e për pasojë edhe koha që kërkonte ishte shumë e madhe, edhe shpërblimi gjithashtu. Puna e saj e lidhur me një kompani fikse nuk ishte më drejtimi kryesor dhe konsulenca nisi të merrte vendin e duhur. Një dhomë e shtëpisë u shndërrua në zyrë, oraret u sfumuan duke lënë dorë të lirë për ndërtimin e axhendës ditore dhe çdo gjë u kthye në një shtojcë natyrale, ku pati luksin të shijonte kohën duke vendosur kufijtë e saj. Ama, ora biologjike e një gruaje është në kontradiktë të madhe me orën profesionale. Në moshën 33-vjeçare ajo u bë nënë dhe aty kuptoi se përveç përmasës së re që merr shpirti, merr edhe përgjegjësinë e jashtëzakonshme për t'iu dedikuar siç duhet këtij rrugëtimi të ri. Tani e gjen veten me një vajzë 3-vjeçare dhe në një program ku janë të përfshirë mbi 160 persona nga e gjithë bota, në kërkim të asaj formulës që balancon jetën dhe punën duke i lënë kohë ndonjë arratie të vogël.

Nga: **Santana Çomora**
Dizajni: **Aldo Beshiri**
Fotografia: **Renato Hyselli**



- Në pamje të parë dukesh natyrë mjaft e brishtë dhe shumë feminine. Pse zgjodhe pikërisht këtë drejtim në jetë? Çfarë të shtyu apo ishte një zgjedhje momentale, por që rezultoi e vlefshme?

Në të vërtetë në fillimet e mia, ku puna ishte thellësisht teknike nuk jam shoqëruar nga ndonjë sukses mjaft domethënës. Çasti fatlum që bëri ndryshimin tek unë ishte kur m'u besua drejtimi i projekteve, sepse në zemër të menaxhimit të tyre është menaxhimi i ekipeve dhe çdo personi që ka interesa ndaj një projekti. Në këtë rol unë munda të përdor karakteristikat e mia natyrale si ndjeshmëria e lartë, inteligjenca emocionale për të kuptuar qasje edhe kur vijnë nga shtigje kuptimore shumë të ndryshme nga të miat. Ajo që duhet të kuptohet veçanërisht nga vendosja në krye të një projekti ku anëtarët e ekipit vijnë nga çdo cep i globit, është që secili prej tyre sjell qasjen e vetë unike, kulturore e disiplinore ndaj punës. Natyra ime mjaft e përqendruar tek

njerëzit, për t'i kuptuar, akomoduar, bërë të ndjerë të respektuar dhe të mbështetur, ka qenë faktor shumë i rëndësishëm për rolin që kam pasur në këto projekte.

- Kur e kuptove që dega që kishe zgjedhur do të ishte dega e së ardhmes?

Zgjedhjet e degëve bëhen tipikisht 17 vjeç, kur je në maturë dhe asokohe nuk kam pasur vështirësi shumë afatgjatë. Ama, roli i prindërve ka qenë thelbësor, eksperiencia e tyre e eklipsonte naivitetin e moshës sime dhe kemi pasur diskutime të gjata mbi disa alternativa, derisa unë bëra zgjedhjen time. Unë mendoj që tashmë teknologjia është pjesë përbërëse e çdo profesioni, edhe nëse nuk zgjidhet si degë më vete, pothuaj në çdo drejtim ku do të shkosh, do të kesh të bësh me pajisje, programe e shumë elemente të tjerë teknologjike. Mendoj që çdo degë është e nevojshme dhe ka të ardhme, ndaj të rinjtë duhet të zgjedhin atë ku aftësitë e tyre shkëlqejnë më shumë, duke qenë gjithmonë

të ndërgjegjshëm mbi komponentin teknologjik.

- Seç kanë një prerje tjetër programuesit apo teknologët e informacionit apo ndoshta kështu i shoh unë. Mund të na përmendësh disa cilësi po patën për ty, se ndoshta syri im i sheh ndryshe?

Një shaka popullore mbi rolin tim thotë që ne, drejtuesit e projekteve jemi shpesh herë baby-sitter të mirë paguar. Përpos shakasë, brenda teknologjisë së informacionit ka një larmi aq të madhe nën-ndarjesh sa besoj i gjen të gjitha ngjyrat njerëzore. A i ka përkëdhelur pak tregu së fundmi këto profesione me ofertat e larta? Po, e pranoj. Ama, puna e tyre është shumë e vështirë, ka aq komponentë teknikë, abstraktë, krijues dhe nevojë për t'i balancuar të gjitha këto, sa nuk do të mund ta bënin dot të gjithë, të paktën jo me sukses. Unë jam fatlume që kam hasur njerëz të natyrave nga më të ndryshmet, dhe që kam pasur dhe kam ekipe kaq profesionale.





Një menaxher sado i mirë, nuk është asgjë pa një ekip shumë të mirë. A mund të ekzistojë një dirigjent pa orkestër? Ndaj jam mirënjohëse për çdo ngjyrë njerëzore që më është shfaqur, edhe pse komunikimet ndonjëherë mund të kenë qenë pak si kode për t'u deshifruar.

- Kryesisht në këtë profesion kemi parë më shumë meshkuj. Ti si e ke gjetur veten? Si të kanë pranuar? A e ke ndier diferencën e gjinisë dhe a ke pasur ndonjëherë ndonjë moment që je vënë në vështirësi e ke dashur ta lësh?

20 vite më parë, kur unë fillova studimet, raporti ka qenë mjaft drastik. Përafërsisht në vitin e parë të studimit raporti ka qenë 10 vajza karshi 120 djemve. Vëmendja dhe presioni vinin natyrshëm, ndonjëherë edhe jo të qëllimshme, por binim jashtë modelit të zakonshëm dhe kjo tërhoqte vëmendje, krijonte pyetje. Rol shumë të rëndësishëm ama kanë luajtur meshkujt që kam pasur pranë, im atë, im vëlla dhe së fundmi bashkëshorti im, të cilët

kanë qenë mbështetës të jashtëzakonshëm të çdo suksesi dhe dështimi timin, sepse jeta i ka të gjitha. Nëse do të veçoja një moment ku e kam ndierë më shumë peshën e të qenit grua, ka qenë ditën kur vajza ime sapo kishte mbushur 3-muajshe dhe unë duhet të filloja punë, përndryshe rriskoj një marrëveshje nga ku varej e ardhmja ime financiare në atë kohë. Ishte shumë herët për mua, fizikisht dhe psikologjikisht, dhe vetëm sepse familja, veçanërisht mamaja ime, sakrifikoi kohën e saj për të më mbështetur, e pata të mundur ta kaloja atë fazë të vështirë.

- Ke tentuar ndonjëherë të largohesh nga Shqipëria?

Do gënjeja po të thosha jo. Ama, kam arritur në përfundimin që duhet dëshira shumë e madhe apo ndonjë arsye shumë madhore për ta bërë atë hap. Në ato pak herë kur unë dhe im shoq kemi pasur oferta nga jashtë të vlefshme për t'u diskutuar, peshorja ka anuar gjithmonë tek qëndrimi këtu.

- Si e shikon të

ardhmen e kësaj bote në vazhdim? Çfarë do zëvendësojë Inteligjenca Artificiale dhe çfarë do të lërë?

Inteligjenca artificiale ka qenë prej kohësh e pranishme, edhe motori i kërkimit të Google është inteligjencë artificiale. Risitë e fundit në këtë drejtim janë të mëdha, ama jo të papritura. Njerëzimi ka njohur pa fund zhvillime domethënëse, shembull i ngjashëm mund të jetë industrializimi i shoqërisë, ku shumë punë manuale u zëvendësuan nga makineritë dhe njerëzit morën drejtime të tjera. Epoka jonë po prodhon mjete që përdorin Inteligjencën Artificiale për të zëvendësuar disa aspekte në një numër të kufizuar profesione. Është aspekt shumë i pritshëm i zhvillimit të përhershëm të dijes njerëzore. Do të zëvendësojë disa rutina mendoj që ne të kemi mundësi të zhvillojmë aftësi të tjera.

- Jam kurioze. Ju si një njeri që tërë kohës merreni me këtë punë kam një pyetje: A do dashurojnë më vonë

njerëzit apo dhe ndjenja do të zëvendësohet nga programe kompjuterike?

Çdo gjë është njerëzore, edhe programet që ne ndërtojmë vijnë nga nevoja e njerëzve, në një rast për të pasur më shumë mundësi të arrijnë produkte që si kanë fizikisht afër apo për të kuruar një simptomë përmes implanteve, siç është programi më i fundit ku unë marr pjesë. Njeriu është në thelbin tonë dhe teknologjia është aty për t'i ardhur në ndihmë njeriut. Asgjë nuk mund të zëvendësojë njeriun, ndjenjën dhe dashurinë që ngadhënjën gjithmonë.

- Si është të punosh freelance? Cilat janë benefitet dhe disfavoret e të punuarit nga shtëpia?

Përfitimi më i madh është liria, unë jam e lirë të ndërtoj axhendën time dhe të përpiqem të adresoj shumë gjëra brenda një dite. Kjo duhet të shoqërohet me një rregull dhe disiplinë shumë të madhe nëse do të duhet të bësh punë serioze dhe cilësore. Nga ana tjetër

situatat ku mua më kanë vënë pozicionimet në ekipe të mëdha globale, më kanë sjellë eksperiencë rritjeje profesionale të jashtëzakonshme, janë sfida që s'do t'i kisha hasur asnjëherë ndoshta në një rol tjetër. Magnituda e mundësive të ofruara është në nivele kompleksiteti më e lartë. Të jesh në një program me mbi 15 ekipe që punojnë njëkohësisht mbi të njëjtin produkt është mundësi që ta ofrojnë korporata, të cilat ndoshta nuk gjenden dot afër zonës tonë gjeografike. Ama, duhet pranuar që çdo dritë ka hijen e saj. Izolimi është një aspekt i pamohueshëm, distanca me njerëzit për një kohë të gjatë nuk është diçka që do ta rekomandoja, edhe për natyra solitare si unë. Ndaj kam mësuar të vlerësoj shumë më tepër kohën që shpenzoj me njerëzit dhe veçanërisht ato darkat me mikeshat e mia.

- Është e vështirë të vendosësh kontakte me kompanitë dhe njerëzit kur e mendojnë se ku jeton ti?

Unë nuk jetoj në iluzion, e di shumë mirë që nëse një kompani do vijë tek unë, vjen fillimisht për indeksimin e ulët ekonomik të vendit tonë. Vjen për të paguar më pak nga sa do të paguante një menaxher projektesh amerikan apo gjerman. Në këtë aspekt nuk ka qenë e vështirë, ofertat kanë ardhur, jemi treg interesant talentesh për raportin cilësi-çmim, edhe pse treg mjaft i vogël. Për mua vështirësia më e madhe në çdo klient të ri është të shihem përtej kuadrit të lehtësisë ekonomike, të vlerësohem më tepër për aftësitë dhe njohuritë. Kam punuar shumë mbi rritjen profesionale. Kam investuar në trajnime e certifikime të njohura ndërkombëtare mjaft të kushtueshme dhe përpjekjet për të marrë mbrapsht benefitet e këtyre investimeve janë të përditshme. Jo pak rëndësi ka pasur edhe mbajtja a një profili publik profesional të kuruar, si ai në LinkedIn nga ku kam marrë disa oferta.

- Po për të punuar për kompani të huaja të mëdha (më përmend

disa me emra) në krahasim me ato këtu?

Duhet një partner shumë i fortë profesional që të qasë klientë të mëdhenj ndërkombëtarë. Unë kam një marrëveshje të gjatë tashmë me MentorMate, një kompani globale konsulence, me një vendosje mbi 20-vjeçare në treg, e cila ka në portofol klientë si Astra Zeneca, Royal Bank of Canada apo Canon Medical e shumë të tjerë. Megjithatë, nuk mund të mohoj faktin që përgatitja ime ka ardhur nga këto kompani shqiptare, që vërtet e kanë tregun e veprimit më të kufizuar, ama ka qenë puna dhe njohuria në to që shërbyen si baza të forta për më tej.

- Cilat janë projektet më të rëndësishme që keni zhvilluar në karrierën tuaj freelance dhe si i jeni përshtatur nevojave të klientëve?

Gjithmonë sytë janë nga e ardhmja, ndaj them projekti im më i rëndësishëm është ai që do të bëj më tej. Nëse do të veçoja një për impaktin njerëzor të prodhuar, do të thosha programi mbi adresimin e problematikave të apneas së gjumit përmes

disa implanteve specifike, të cilat ndihmojnë në një frymëmarrje më të mirë. Sa herë sjell në mendje pacientët dhe dëshmitë e tyre mbi mënyrën si ju ka ndikuar kjo zgjidhje për të përmirësuar jetën e tyre, ndiej që kam bërë diçka me vlerë.

- Si e organizoni kohën tuaj për të përfunduar me sukses projekte të ndryshme të freelance?

Rregullsi, disiplinë dhe kulturë punë e ndryshme nga ajo e punës në zyrë. Duhet të kuptohet që unë nuk organizoj vetëm kohën time, por jam përgjegjëse për të koordinuar edhe programin e ekipit dhe klientëve, e njëkohësisht e gjitha duhet të përkthehet në një realizim kohor të projektit. Nuk ka qenë e thjeshtë përshtatja në fillim, sepse terreni i veprimit është shumë i ndryshëm nga një punë ku të gjithë janë të vendosur në të njëjtin vend dhe kanë orar të njëjtë pune. Kolegët me të cilët punoj tani vijnë nga zona të ndryshme oraresh, edhe ata si unë kanë zgjedhur modalitetin freelance të punës ndaj kanë edhe fleksibilitetin e të pasurit të kalendarëve me orë të shpërndara gjatë ditës. Kështu që më është

dashur shumë punë vetjake për të vendosur veten si fillim në disa rregulla të hekurta si ndërtimi i axhendave shumë më përpara në kohë, vendosja e marrëveshjeve me ekipin që në fillim të projektit mbi rregullat e komunikimit asinkron që do të respektojmë dhe negocimi me çdo klient për të vendosur pritshmëritë e duhura se kur dhe si do të jetë çdo komunikim.

- Mes angazhimesh kaq të shumta profesionale si arrite të gjeje dashurinë e jetës e të vendosje që kjo është zgjedhja e duhur e më pas të bëheshe nënë?

Është fat shumë i madh që jeta të të sjellë në udhë partnerin e duhur. Duke e njohur fillimisht si koleg tim shoq, pashë tek ai një pasion për punën dhe dedikim që me motivuan edhe mua shumë. Është një model për mua në vlerat që manifeston. Krijimi i familjes më pas qe punë shumë e madhe e të dyve dhe vendimi për të pasur një fëmijë u duk rrjedha më natyrale dhe shumë e dëshiruar që na bëri më të plotë në çdo drejtim. Pak dija se sa e lodhshme do të ishte, por jemi të dy dhe çdo gjë bëhet më e lehtë.

- Do të ishte kaq e lehtë nëse partneri do të ishte i një profesioni tjetër? Do ta gjenit gjuhën e përbashkët?

E kam të vështirë ta imagjinoj, sepse im shoq ka qenë dhe vazhdon të jetë një këshillues shumë i mirë në çdo vendim timin dhe fakti që ai kupton shumë mirë terrenin ku unë veproj e bën më të lehtë padyshim.

- Sot, si nënë mund të na përshkruash një ditë tënden? Si fillon e si mbaron?

Sa do të doja të thosha që fillon me meditim. Në fakt mëngjeset janë shumë të ngjeshura. Duke qenë se ditët e mia nuk janë të njëjta, si në kohë dhe në takime, mëngjesi fillon duke konsultuar axhendën e ditës. Në mendjen time kaloj gjithë ditën për të parë takimet, orët e bllokuara dhe ato të lira. Më pas, çoj

vajzën në kopsht dhe ndaloj të marr kafënë të cilën e pi gjatë rrugës për t'u kthyer në shtëpi, ku kam edhe zyrën. Më ka ndodhur gjatë këtyre viteve të kem tek-tuk edhe ndonjë konsulencë të vogël me kompani apo institucione vendase dhe ka rastisur që dita të fillojë me një takim apo ndalesë tek zyrat e tyre. Koha e mesditës për mua është aty ku vrulli i komunikimeve është më i madh, sepse diku është fillimi i ditës së punës, diku fundi dhe në zonën tonë mesi i ditës, ndaj është orari më i mbivendosur për të gjitha palët në zona të ndryshme orare për të komunikuar. Pjesa e dytë e ditës është më e çrregullt, diku mund të lë një takim virtual apo fizik, ose nëse kam boshllëk kohor, e marr vajzën nga kopshti. Zakonisht, darka është dedikim absolut ndaj familjes. Pasi e vogla fle, mund të mbyll ndonjë

punë, komunikim, raport që nuk e kam mbyllur gjatë ditës. Këtë po mundohem ta përmirësoj, që të mos kem nevojë të punoj në orët e vona. E, përpara gjumit vjen rituali i kujdesit për veten, për lëkuren, flokët etj. që për mua është thuajse terapeutik.

- Përtej teknologjisë cilat janë pasionet e tua që nuk prishin aurën e informacionit?

Koha e lirë është luks në këtë fazë të jetës, por fundjavat që na japin më tepër frymë i shpenzojmë duke shijuar ndonjë ambient të qetë nën shoqërinë e një vere shumë të mirë. E nëse kam një javë bujare i dhuroj vetes një ndalesë në Teatrin e Operas dhe Baletit, me shfaqjen e radhës. Do të doja të thosha edhe teatër, por do ta mbyllja me shumë trishtim këtë bisedë nëse do të flisja për teatrin. Ndaj, për ta mbyllur

bukur, t'i rikthehem verës, e siç ka thënë poeti ynë i mençur Xhevahir Spahiu, "Pini se vreshtat s'mbarojnë, mbaron vetëm jeta e ngratë". Gëzuar!

